

Këshilli i Komunës së Kërçovës

Nr. 08-3237/2

26.12.2024

K e r ç o v ë

PROCESVERBAL

Nga seanca e 43-të e Këshillit të Komunës së Kërçovës, e mbajtur më datë 26.12.2024 në hapsirat e Këshillit të Komunës së Kërçovës me fillim në ora 10:00.

Seancën në ora 10:00 e hapi dhe me të udhëhoq kryetari i Këshillit të Komunës së Kërçovës Skender Xhabiri, ndërsa të pranishëm ishin këshilltarët: Kamerr Klosi, Drenuse Dalipi, Filip Mitreski, Mihajlo Daniloski, Violeta Spasenoska, Olgica Poposka, Igor Stojanoski, Daniela Poposka, Anto Trajanoski, Tefik Lutfiu, Valentina Llazaroska, Bojan Stojkoski, Ivanço Bozhinoski, Viktor Aleksoski, Sibel Tufkegji, Abdulla Sejdini, Fortesa Sejdini, Ramazan Zulbeari, Migjen Zendeli dhe Nexhbi Dervishi.

Në mungesë ishte këshilltarja: Valbona Adili Emini

Të pranishëm në seancë ishin: Fatmir Dehari - kryetar i komunës, Aneta Nasteska - sekretare e komunës, Valdet Selimi, Burim Kadriu, Igor Pejoshi, Emilija Petkoska - përfaqësues të administratës komunale, zëvendës drejtori i NP "Komunalec", drejtori i Universitetit të Punës "Krste Misirkov", UD drejtori i SHF "Kuzman Josifoski Pitu", drejtori i SHF "Dr. Vladimir Polezhinoski", drejtori i SHF, Sande Shterjoski, drejtori i SHF, Hristo Uzunov", drejtori i SHF, Gj.K. Skenderbeu,, Sërbicë, drejtori i SHF "Milton Gurra", drejtori i SHF "Naim Frasheri", zv.drejtori i SHF "Faik Konica", drejtori i SH.F. "Rexhë Rushit Zajazi", kryetari i këshillit shkollor të SHMK "Mirko Mileski", kryetari i këshillit shkollor të SHMK "Drita", UD drejtori IPKQF „Ollga Miceska,, njerëz nga diaspora, si dhe si gazetarë të TV "Uskana", Gurra, "MTV" dhe "TV 21".

Kryetari i Këshillit e përshëndeti Kryetarin e Komunës dhe të gjithë të pranishmit, duke i njoftuar se kjo seancë ishte e rëndësishme, pasi që do të silllet Buxheti i Komunës për vitin 2025.

Më pas, Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Procesverbalin e seancës së 42-të të Këshillit të Komunës së Kërçovës, të mbajtur më 26.11.2024 dhe i njejtë u miratua me 21 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Kryetari i Këshillit informoi se administrata komunale ka kërkuar që pika e 24-të nga rendi i ditës të tërhiqet për këtë seancë, për shkak të lëshimeve që është dashur të shqyrtohen dhe të vendoset si pikë e rendit të ditës për seancën e ardhshme.

Kryetari i këshillit për këtë seancë propozoi rendin e ditës si vijojn:

R E N D I I D I T Ë S

1. Propozim Buxheti i Komunës së Kërçovës për vitin 2025.
2. Propozim Vendimi për realizimin e Buxhetit të Komunës së Kërçovës për vitin 2025.
3. Propozim Plani financiar vjetorë për vitin 2025 të SHFQ “Kuzman Josifoski Pitu” Kërçovë.
4. Propozim Plani financiar për vitin 2025 të SHFQ “ D-r Vlladimir Pollezhinoski ” Kërçovë.
5. Propozim Plani financiar për vitin 2025 të SHFQ “Sande Shterjoski” Kërçovë.
6. Propozim Plani financiar për vitin 2025 të SHFQ “Hristo Uzunov” f.Drugovë.
7. Propozim Plani financiar për vitin 2025 të SHFQ “GJ.K.Skenderbeu” f.Sërbicë.
8. Propozim Plani financiar për vitin 2025 të SHFQ “Milto Gurra” f.Strellcë.
9. Propozim Plani financiar për vitin 2025 të SHFQ “Naim Frashëri” f.JagollDolencë.
10. Propozim Plani financiar për vitin 2025 të SHF “Faik Konica” f.Greshnicë.
11. Propozim Plani financiar për vitin 2025 të SHF “Rexhë Rushiti Zajazi” f.Zajaz.
12. Propozim Plani financiar për vitin 2025 të SHMK “Mirko Mileski” Kërçovë.
13. Propozim Plani financiar për vitin 2025 të SHMK “Drita” Kërçovë.
14. Propozim Plani financiar për vitin 2025 të IPK Ç.F “Ollga Miceska” Kërçovë .

15. Propozim Plani financiar për vitin 2025 të IK U.P “Krstë Mistirkov” Kërçovë.
16. Propozim Programi në lëminë e sportit dhe rekreimit për vitin 2025
17. Propozim Programi për aktivitetet e Komunës së Kërçovës në lëminë e mbrojtjes dhe shpëtimit të qytetarëve dhe të mirave materiale nga fatkeqësit natyrore dhe fatkeqësitë të tjera si dhe revitalizimin pas eliminimit të krizës për vitin 2025.
18. Propozim Program dhe aktivitete në lëminë e menaxhimit me mjedisin jetësorë në Komunën e Kërçovës për vitin 2025.
19. Propozim Plan dhe Program për zgjidhjen e problemit me kafshët e pa strehë në territorin e Komunës Kërçovës për vitin 202.
20. Propozim Plan dhe Program operativ për dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim (si pjesë nga masat e përgjithshme për parandalimin dhe heqjen e smundjeve infektuese).
21. Propozim Program për Barazi gjinore në Komunën e Kërçovës për vitin 2025.
22. Propozim Program Per aktivitet e Komunës së Kërçovës në lëminë e Arsimit për Vitin 2025.
23. Propozim Program për aktivitetet nga lëmia e Mbrojtjes Shëndetësore në Komunën e Kërçovës për vitin 2025.
24. Propozim Program për festat dhe shënimet e ngjarjeve jubilarë dhe datave të rëndësishme në Komunën e Kërçovës për vitin 2025.
25. Propozim Program për financimin e aktiviteteve nga lëmia e kulturës nga interesi i Komunës së Kërçovës dhe përkrahje shoqatave të qytetarëve për vitin 2025
26. Propozim Program për aktivitetet e Komunës së Kërçovës në lëminë e Mbrojtjes sociale dhe mbrojtje të fëmijëve gjatë vitit 2025.
27. Propozim Program për aktivitetet e Komunës së Kërçovës për mbrojtje nga zjarret gjatë vitit 2025.
28. Propozim Program për menaxhim me mbeturinat në territorin e Komunës së Kërçovës për vitin 2025
29. Propozim Program për punë dhe zhvillim të Ndërmarrjes publike për veprimtari komunale “Komunalec” Kërçovë për vitin 2025.
30. Propozim Program për mirmbajtje të pastërtisë publike për vitin 2025 në Komunën e Kërçovës.

31. Propozim Vendim për dhënie e banesës sociale për shfrytëzim nën qira.

32. Të ndryshme.

Kryetari i Këshillit e propozoi për miratim tërheqjen e pikës së 24-të nga rendi i ditës, Propozim Program për festat dhe shënimet e ngjarjeve jubilarë dhe datave të rëndësishme në Komunën e Kërçovës për vitin 2025 dhe e njejtë u miratua me 20 vota PËR, 1 votë KUNDËR. PËRMBAJTUR (asnjë).

Më pas, Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim propozimin e rendit të ditës për këtë seancë, pa pikën e 24-të, dhe e njejtë u miratua me 21 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

1. PIKA E PARË: Propozim Buxheti i Komunës së Kërçovës për vitin 2025.

Kryetari i Këshillit hapi debatin ndërsa fjalën e mori:

Kryetari i Komunës, Fatmir Dehari, i përshëndeti këshilltarët, duke theksuar se e vlerëson punën e tyre, pavarësisht se nga cila parti politike vijnë. Ai theksoi se Kërçova është Maqedoni në miniaturë, ku jetojnë bashkë maqedonas, shqiptarë, turq, romë etj. Dhe mund të vërtetohet se e ardhmja mund të krijohet. Ai informoi se këtu janë të pranishëm edhe njerëz nga diaspora të cilët investojnë në Kërçovë dhe janë shembull i mirë i bashkëpunimit me diasporën. Ai theksoi se viti i kaluar ishte vit i suksesshëm dhe zgjedhor, ndërsa tani kemi një qeveri të re, e cila shpreson se do t'i respektojë qytetarët dhe do t'i realizojë pritjet për të hyrë në Evropë. Është e nevojshme të zbatohen të gjitha projektet për të ecur përpara. Ai informoi se Buxheti është përgatitur në mënyrë transparente me pjesëmarrjen e të gjithë qytetarëve në qytet dhe punëtorëve migrantë. Ai theksoi se në jemi komuna më transparente në vend dhe se çdo qytetar merr pjesë në vendimmarrjendërsa gjithashtu kështu thonë institucionet shtetërore. Ai ka falënderuar mediat për praninë e tyre në të gjitha takimet që kanë pasur. Ai informoi se buxheti është bërë në bazë të propozimeve dhe ideve nga takimet e mbajtura me të gjitha palët e interesuara në qytet dhe për këtë ka raport përfundimtar në web faqen e komunës. Ai ka theksuar se ky buxhet nuk është si buxheti i mëparshëm dhe se është kërkesë e të gjithëve në komunë, sepse të gjithë janë të përfaqësuar në përgatitjen e tij. Ai informoi se buxheti është 1.173.960.500 denarë dhe do të bëjnë maksimumin për realizimin e tij. Më pas, shpjegoi buxhetin në detaje. Ai theksoi se jemi komuna e parë që shfrytëzojmë fondet evropiane në vitin 2025. Projekte të tilla do të vazhdojnë dhe mjetet prej tyre do të përdoren, të cilat do të realizohen në Buxhet si mjete shtesë.

Abdulla Sejdini – Bën me dije se Buxheti i vitit 2025 ka rritje krahasuar me buxhetin e vitit 2024. dhe ka risi që duhej të zbatoheshin, programe të reja për shëndetësinë, arsimin etj. Ai e pyeti kryetarin e komunës për donacionet nga vendet e huaja, të cilat arrijnë në 10 milionë, ku planifikon t'i shpenzojë 4 milionët për vitin 2025 dhe për çfarë janë të destinuara të njejtat. Gjithashtu te sporti dhe rekreacioni janë paraparë 32 milion, dhe a do të përfundohet “Jançica” me 2 milion të planifikuar për vitin 2025. Ka pasur një rënie të shpenzimeve kapitale, te rikonstruimi i objekteve sportive janë paraparë 15 milionë, pyeti se për cilat objekte bëhet fjalë.

Kryetari - Informon se po punohet në rregullimin e objektit sportiv të komandës që është afër komunës dhe një objekti sportiv në shkollën fillore “Sande Shterjoski”. Rënie ka pasur te “Jançica” sepse ndërtimi ishte drejt përfundimit. Renovimi i rrugës “Rudniçka” ishte duke u zhvilluar në vlerë prej 400 mijë euro dhe ishte investim i huaj nga Banka Botërore, fondet IPA dhe Banka Evropiane.

Abdulla Sejdini – Bën me dije se planet në shkolla i kanë votuar, por tani ka pasur një realitet të ri. Ata votuan që punësimi në shkolla të bazohej në balancues, por tani nuk kishte balancues dhe ndonjë mekanizëm tjetër punësimi. A do të konsiderohet si një alternativë në procesin e punësimit në arsim gjatë 2025, apo do të duhet të kërkojnë dalje që votuan për një program me balancues?

Kryetari i Komunës – Informoi se shkollat janë të pavarura në punësim dhe komuna nuk ka ndërhyrë. Kjo është bërë në bazë të Ligjit për Arsimin Fillor dhe të Mesëm. Politika nuk duhet të ketë ndikim në shkolla. Ai bën me dije se i është hequr kompetenca për 2 shkolla në të njëjtën ditë nga Ministria e Arsimit. Ministri nuk gjeti kohë ta diskutonte me të. Ai sugjeroi që politika të mbahet jashtë shkollave.

Abdulla Sejdini - Informon se politika ka depërtuar thellë në Kërçovë dhe sygjeron që Ministria e Arsimit të mos i heqë kompetencat Kryetarit dhe kjo të mos ndodhë më.

Kryetari i Këshillit informoi se në Buxhet janë dorëzuar disa amendamente. Vazhdohet me shqyrtimin e tyre.

Amendamenti 1

Mihajlo Daniloski - Informon se amendamenti është propozuar nga grupi këshillues i VMRO-DPMNE-së dhe koalicioni, ata kanë tentuar që për 4 vite mjetet për qytetarët t'i vendosin në rend të parë. Në vitin 2021-22 janë ndarë 3 milion, ndërsa tani 7 milionë dhe gjithçka ishte e mirë për të gjithë. Propozoi që plani urbanistik F10, i cili arrin vlerën 1,300,000 den, të ndryshohet në 1,000,000 den dhe fondet prej 300,000 den të transferohen në pikën 464 Transferta të ndryshme për rritjen e mjeteve për transferet në mbështetje të organizatave joqeveritare, studentëve dhe shoqatat e qytetarëve. Ai kërkoi mbështetje nga këshilli.

Kryetari i Komunës – Informon se planifikimi urbanistik është një hallkë kyçe për qytetin, pavarësisht se sa zbatohet. Si rezultat i saj, bëhen investime. Ai theksoi se duke filluar nga viti i ardhshëm në qytetin tonë do të ketë një “LIDL” që do të jetë një burim i mirë të ardhurash për zhvillimin e qytetit.

Burim Kadriu - Ai i propozoi këshillit që të mos pranohet amendamenti, sepse për ata qytetarë janë paraparë mjete në programe dhe nuk ka pasur nevojë për një reduktim të tillë në atë program.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim amendamentin e propozuar dhe nuk u miratua me 6 vota PËR. 15 vota KUNDËR. PËRMBAJTUR (asnjë).

Amendamenti 2

Mihajlo Daniloski - Informoi se edhe ky amendament është i VMRO-DPMNE-së dhe koalicionit dhe theksoi se kërkon që të bëhen ndryshime në nënprogramin e këshillit të AOO-së. Nga zëri 471 kompensime sociale, shuma prej 600.000 denarë duhet të zëvendësohet me 800.000 denarë, dhe 200.000 denarë të merren nga nënzëri 426210 përfaqësime, dhe në vend të 250.000 tani të jenë 50.000 denarë, me qëllim të rritjes së ndihmave sociale për qytetarët në nevojë sociale.

Burim Kadriu - Propozoi që të mos pranohet amendamenti, sepse në ato zëra ishin paraparë 1 milion e 200 mijë denarë, në bazë të programit të komisionit dhe kërkesave të parashtruara. Mjetet e planifikuara për vitin 2024 ishin të mjaftueshme për atë

qëllim. Asnjë reduktim nuk mund të bëhej nga ato zëra, sepse ishin të mjaftueshëm për to.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim amendamentin e propozuar dhe nuk u miratua me 6 vota PËR. 15 vota KUNDËR. 1 votë PËRMBAJTUR.

Amendamenti 3

Mihajlo Daniloski - Informon se edhe këtë amendament e ka paraqitur grupi këshillues i VMRO-DPMNE-së dhe koalicionit dhe propozon që zëri 421400 transport i personave të rritet nga 300.000 në 500.000. Mjetet duhet të sigurohen nga nënzëri 426210, përfaqësimi i kryetarit të komunës dhe në vend të 700.000 tani të jenë 500.000 denarë dhe të përdoren për rritjen e mjeteve për transportin e nxënësve të shkollave të mesme.

Burim Kadriu - Informon se nuk duhet pranuar, sepse për vitin 2025 ishin paraparë mjete prej 15 milionë denarë, sepse mjetet nga bllok-dotacionet nuk ishin të mjaftueshme për këtë.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim amendamentin e propozuar dhe nuk u miratua me 6 vota PËR. 15 vota KUNDËR. 1 votë PËRMBAJTUR.

Amendamenti 4

Mihajlo Daniloski - Informon se edhe ky amendament është dorëzuar nga grupi këshillues i VMRO-DPMNE-së dhe koalicionit dhe ka të bëjë me ndryshimet në nënzërin J80 shërbimet tjera komunale. Propozohet që në nënzërin 425510 shërbime veterinare shuma prej 1.500.000 të zëvendësohet me 1.900.000 denarë, ndërsa mjetet të transferohen nga nënzëri 421320 telefon dhe telefaks nga programi AOO në këshill për rritjen e mjeteve për shërbime veterinare dhe zgjidhjen e problemit me qentë endacak.

Burim Kadriu - Ka propozuar që të mos pranohet, sepse edhe për këtë janë ndarë mjete dhe telefonat zyrtarë të këshilltarëve janë paguar nga mjetet e ndara për telefona.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim amendamentin e propozuar dhe nuk u miratua me 6 vota pro. 15 vota KUNDËR. 1 votë PËRMBAJTUR.

Amendamenti 5

Valentina Lazarevska - Informon se ky amendament është propozuar nga grupi këshillues i VMRO-DPMNE-së dhe koalicionit dhe propozon që të bëhen ndryshime në nënprogramin për arsim N10 dhe në nënzërin 424210 - Mirëmbajtja e ndërtesave, në vlerë prej 3.023,00 denarë. zëvendësohet me 3623.00 den. dhe mjetet do të sigurohen nga nënzëri 464990 e programit për mbrojtjen e mjedisit R 10 dhe në vend të 5.000.000 do të jenë 4.400.000, për të siguruar një mjedis të shëndetshëm mësimor, duke blerë pastrues ajri në shkollat fillore në territorin e komunës.

Burim Kadriu - Ai ka propozuar që të mos pranohet, sepse 90% e programeve buxhetore bëhen në bazë të takimeve me institucionet dhe qytetarët, kështu që edhe ai program është përgaditur. Ai ka theksuar se për momentin nuk janë gati për një ndryshim të tillë.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim amendamentin e propozuar dhe nuk u miratua me 7 vota PËR. 14 vota KUNDËR. 1 votë PËRMBAJTUR.

Burim Kadriu – Bën me dije se ka pasur edhe një ndryshim, përkatësisht në të hyrat në 741141 do të rriten për 29 milionë për shkak të pagesës së dokumentacionit të operatorëve që nuk janë paguar në vitin 2024 dhe do të paguhen në vitin 2025.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propzim Buxheti i Komunës së Kërçovës për vitin 2025 me ndryshimin e propozuar dhe u miratua me 16 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 6 vota PËRMBAJTUR.

Kryetari i Komunës- I falënderoi këshilltarët për miratimin e buxhetit, për mbështetjen dhe konstruktivitetin e tyre. E faleminderoi Valen për amendamentet. Ai kërkoi që të ngrihet zëri dhe theksoi se në regjistrimin e fundit shtetëror nuk janë përfshirë përfaqësues nga diaspora. Sipas regjistrimit, komuna kishte 56721 banorë, nga të cilët 36 mijë jorezidentë. Diaspora ka investuar këtu dhe ishte e nevojshme që të përfshihet, dhe jo të mënjanohet. Ai bën me dije se për zgjedhjet e ardhshme lokale, në bazë të numrit të banorëve në qytet po humbasin 3 këshilltarë. Ai ka theksuar se kjo duhet korrigjuar dhe se duhet të ketë respekt për diasporën, e jo diskriminim ndaj saj. Ai i falënderoi të gjithë dhe i uroi një vit të suksesshëm dhe të frytshëm.

2. PIKA E DYTË: Propozim Vendimi për realizimin e Buxhetit të Komunës së Kërçovës për vitin 2025.

Burim Kadriu - Ai ka shpjeguar vendimin dhe ka bërë të ditur se në të ka disa gabime teknike që do të korrigjohen.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendimi për realizimin e Buxhetit të Komunës së Kërçovës për vitin 2025 dhe i njejtë u miratua me 22 vota PËR, KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Kryetari i këshillit dha një pushim prej 5 minutash. Pas pushimit seanca vazhdoi.

3. PIKA E TRETË: Propozim Plani financiar vjetorë për vitin 2025 të SHFQ "Kuzman Josifoski Pitu" Kërçovë

UD Drejtori i SHFQ "Kuzman Josifoski Pitu" - informoi se bllok dotacioni është 45 milionë denarë dhe pjesa më e madhe është planifikuar për paga dhe kompensime, ndërsa mjetet e mbetura ndahen sipas artikujve.

Abdulla Sejdini - Ai e përshëndeti UD drejtorin, i uroi sukses dhe e pyeti nëse e shqetësonte fakti që 7-8 punonjësve ua kishte ndërprerë kontratat që në fillim të mandatit dhe pyeti se cila ishte arsyeja e ndërprerjes së kontratave.

UD Drejtori i SHFQ "Kuzman Josifoski Pitu" - informoi se kjo nuk është e vërtetë dhe se ka informata të pasakta. Ai theksoi se për këtë mund t'i përgjigjej me shkrim ose të shkonte në shkollë.

Abdulla Sejdini - Informoi se ata ishin themelues atje dhe i intereson se cili konstatim nuk ishte i saktë dhe se nëse kontratat ishin ndërprerë.

UD Drejtori i SHFQ "Kuzman Josifoski Pitu" – njofton se shkolla ka shpallur shpallje publike në bazë të pëlqimit të marrë për punësim dhe është bërë përzgjedhja e atyre që i kanë plotësuar kushtet. Kontrata është ndërprerë për shkak të skadimit të afatit për të cilin ishin pranuar.

Abdulla Sejdini – Pyeti se nëse individët të cilëve u është ndërprerë kontrata nuk i kanë plotësuar kushtet dhe informoi se përzgjedhja është bërë në bazë të asaj se kush ka qenë i punësuar më parë atje.

UD Drejtori i SHFQ "Kuzman Josifoski Pitu", informoi se nuk ka thënë se punëtorët që kanë punuar aty nuk i kanë plotësuar kushtet apo ishin jo adekuat, por vetëm se u ka skaduar afati i kontratës për të cilën janë angazhuar.

Ivanço Bozhinoski – Pyeti se nëse asnjëri nga personat e punësuar më parë nuk i ka plotësuar kushtet, kriteret për lidhjen e kontratës së re. Ai informon se kjo ka qenë për politikë dhe se herën e fundit kur janë punësuar njerëz të VMRO-së, me ardhjen e LSDM-së në pushtet, nuk është shkarkuar asnjë person, ka qenë një fushatë politike kundër të punësuarëve të mëparshëm.

UD Drejtori i SHFQ "Kuzman Josifoski Pitu" – informoi se kontrata për të cilën ishin të punësuar u ka skaduar dhe se personat e rinj janë përzgjedhur përmes konkursit publik.

Ivanço Bozhinoski - Informon se kjo ishte ajo që nuk e ka kuptuar drejtori, një fushatë politike dhe se asnjëri prej tyre nuk ka mundur t'i plotësojë kushtet.

UD Drejtori i SHFQ "Kuzman Josifoski Pitu", informoi se kjo nuk është e vërtetë dhe se nuk duhet të manipulojnë opinionin.

Kryetari i Këshillit - Ai theksoi se këtu UD drejtori ishte përballë themeluesit të tij dhe duhej të kishte kujdes se si sillej para këshilltarëve.

Abdullah Sejdini - Ai ka pyetur edhe një herë pse është kështu dhe se në atë rast është dashur të ketë kallëzim penal ndaj drejtorit paraprak, sepse ata që kanë qenë të punësuar më parë nuk i kanë plotësuar kushtet, dhe janë punësuar. Ai theksoi se nuk po futet në atë se nëse ka pasur apo jo politikë këtu, por nuk e kupton se si mund t'i ndërpritet kontrata dikujt që ka punuar 3-4 vjet dhe të punësojë të rinj.

UD Drejtori i SHFQ "Kuzman Josifoski Pitu", informoi se ka thënë se ka kaluar koha për të cilën janë punësuar, e jo se nuk i kanë plotësuar kushtet. Përzgjedhja është bërë me shpallje publike dhe nuk ka pasur kundërshtime për përzgjedhjen, arsyeja e vetme ka qenë se koha për të cilën janë pranuar kishte skaduar dhe për këtë arsye është shpallur shpallje publike.

Igor Stojanoski - Informon se nuk ka mbrojtur askënd dhe se kryetari i komunës më herët tha se i janë hequr kompetencat mbi disa shkolla. Ai theksoi se kanë qenë këtu për planin financiar të shkollës dhe duhet t'i përmbahen rendit të ditës. Ai

sugjeroi që diskutimi politik të përfundojë dhe nëse këshilltarët janë dakord mund ta vendosin si pikë e rendit të ditës për seancën e ardhshme dhe të shqyrtohet punësimi.

Tefik Lutviu - Informon se UD Drejtori është dashur ta dijë se ata janë themelues dhe nuk e kanë ditur se nga kush dhe si është emëruar UD. Theksoi së është e nevojshme që më detajisht të sqarohet për punësimet, dhe të mos dëmtohet askush.

Abdulla Sejdini - Informon se ka pranuar ankesa nga dy familje të cilave u janë ndërprerë kontratat, këtu nuk ka pasur politikë, por ka përmendur shqetësimet e atyre familjeve dhe ka kërkuar që të tregohen arsyet.

Igor Stojanoski – Informon se në atë rast edhe atij i është përjashtuar, ndërprerë kontrata nipit të tij dhe pyeti nëse këshilltarët dëshirojnë ta shqyrtojnë dhe ta diskutojnë këtë pikë si pikë të rendit të ditës në seancën e radhës. Këtu në rend dite ishte edhe plani financiar. Ai theksoi se këtu kanë pasur disa herë raste të tilla, sikurse edhe me ndërmarrjet tjera, me planet e tyre financiare, janë bërë shumë premtime, por nuk ka pasur përmirësim.

Abdulla Sejdini - Informon se është i shqetësuar se u janë ndërprerë kontratat dhe se nuk ka pasur problem me planin financiar, UD drejtori ka qenë këtu dhe është dashur të shfrytëzohet prania e tij për t'iu përgjigjur edhe kësaj.

Mihajlo Daniloski - Informoi se nëse ka pasur mangësi në punësim, ka pasur institucione të tjera që është dashur ta zgjidhin atë, ndërsa për planin financiar nuk ka pasur vërejtje dhe është dashur të miratohet.

Abdulla Sejdini – bën të ditur se plani financiar është përkthyer në “Excel”, dhe jo pjesa tjetër.

Mihajlo Daniloski - Informon se është dashur të përkthehet plotësisht, por si çdo gjë tjetër deri më tani, mund ta lënë të gabon 3-4 herë.

UD Drejtori i SHFQ "Kuzman Josifoski Pitu", njoftoi se do ta pranojë vërejtjen dhe do të përkthehet e plotë.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Planit financiar vjetorë për vitin 2025 të SHFQ “Kuzman Josifoski Pitu” Kërçovë dhe nuk u miratua me 7 vota për. 1 votë KUNDËR. 13 vota PËRMBAJTUR.

Këshilltarja Valentina Lazarevska është liruar nga votimi për shkak se është e punësuar në të njejtën shkollë.

4. PIKA E KATËRT: Propozim Planit financiar për vitin 2025 të SHFQ “ D-r Vlladimir Pollezhinoski ” Kërçovë.

Drejtori SHF, dr. Vladimir Polezhinoski, informoi se plani financiar për shkollën e tyre është përgatitur dhe dorëzuar tek ata.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Planit financiar për vitin 2025 të SHFQ “ D-r Vladimir Pollezghinoski ” Kërçovë dhe u miratua me 16 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 6 vota PËRMBAJTUR.

5. PIKA E PESTË: Propozim Planit financiar për vitin 2025 të SHFQ “Sande Shterjoski” Kërçovë.

Drejtori i SHFQ “Sande Shterjoski”, ka shpjeguar planin.

Abdulla Sejdini – Ka informuar se në planin financiar që iu është dorëzuar ka pasur një grafë ku shkruhej “Drita” 2014, pyeti nëse ishte gabim teknik.

Drejtori i SHFQ “Sande Shterjoski”, informoi se bëhet fjalë për një gabim teknik dhe se do të korrigjohet.

Abdulla Sejdini - Informoi se në pikën 42110-rryma në vitin 2024 ka pasur 0, kurse në vitin 2025 600.000 mjete të planifikuara, pyeti pse ishte dhe a nuk ishte gabim teknik.

Drejtori i SHFQ “Sande Shterjoski”, - informoi se kanë qenë të bllokuar për një kohë dhe komuna atëherë ka menaxhuar dhe për këtë ka qenë 0, ndërsa tani po menaxhon ai dhe për këtë arsye janë paraparë 600.000 denarë.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Planit financiar për vitin 2025 të SHFQ “Sande Shterjoski” Kërçovë dhe i njejtë u miratua me 16 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 6 vota PËRMBAJTUR .

6. PIKA E GJASHTË: Propozim Planit financiar për vitin 2025 të SHFQ “Hristo Uzunov” f.Drugovë.

Drejtori i SHFQ „Hristo Uzunov,, informoi se plani financiar ishte rreth 33 milionë, prej të cilëve 31 milionë për paga, ndërsa pjesa tjetër për shpenzime rrjedhëse.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Planit financiar për vitin 2025 të SHFQ “Hristo Uzunov” f.Drugovë dhe i njejtë u miratua me 16 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 6 vota PËRMBAJTUR

7. PIKA E SHTATË: Propozim Planit financiar për vitin 2025 të SHFQ “GJ.K.Skenderbeu” f.Sërbicë.

Drejtori i SHFQ “GJ.K.Skenderbeu” ka shpjeguar planin financiar.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Plani financiar për vitin 2025 të SHFQ “GJ.K.Skenderbeu” f.Sërbicë dhe u miratua me 16 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 6 vota PËRMBAJTUR

8. PIKA E TETË: Propozim Plani financiar për vitin 2025 të SHFQ “Milto Gurra” f.Strellcë.

Ndihmës UD drejtori i SHFQ „Milto Gurra,, shpjegoi planin.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Plani financiar për vitin 2025 të SHFQ “Milto Gurra” f.Strellcë dhe u miratua me 15 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 6 vota PËRMBAJTUR

9. PIKA E NËNTË: Propozim Plani financiar për vitin 2025 të SHFQ “Naim Frashëri” f.JagollDolencë

Drejtori i SHFQ „Naim Frashëri,, shpjegoi planin financiar.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Plani financiar për vitin 2025 të SHFQ “Naim Frashëri” f.JagollDolencë dhe u miratua me 15 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 6 vota PËRMBAJTUR

10. PIKA E DHJETË: Propozim Plani financiar për vitin 2025 të SHF “Faik Konica” f.Greshnicë.

Zëvendës drejtori i SHF “Faik Konica” – Informon se është i autorizuar nga drejtori për të qenë i pranishëm dhe për të sqaruar planin.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Plani financiar për vitin 2025 të SHF “Faik Konica” f.Greshnicë dhe u miratua me 15 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 6 vota PËRMBAJTUR

11. PIKA E NJËMBËDHJETË: Propozim Plani financiar për vitin 2025 të SHF “Rexhë Rushiti Zajazi” f.Zajaz.

Drejtori i SHF “Rexhë Rushit Zajazi”, ka sqaruar planin.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Plani financiar për vitin 2025 të SHF “Rexhë Rushiti Zajazi” f.Zajaz dhe u miratua me 15 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 6 vota PËRMBAJTUR

12. PIKA E DYMBËDHJETË: Propozim Plani financiar për vitin 2025 të SHMK “Mirko Mileski” Kërçovë.

Kryetari i Këshillit shkollor të SHMK-së, „Mirko Mileski,, shpjegoi planin financiar.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Plani financiar për vitin 2025 të SHMK “Mirko Mileski” Kërçovë dhe u miratua me 15 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 6 vota PËRMBAJTUR

13. PIKA E TREMBËDHJETË: Propozim Plani financiar për vitin 2025 të SHMK “Drita” Kërçovë.

Kryetari i Bordit Shkollor të SHMK “Drita”– sqaroi planin financiar.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Plani financiar për vitin 2025 të SHMK “Drita” Kërçovë dhe u miratua me 16 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 6 vota PËRMBAJTUR

14. PIKA E KATËRMBËDHJETË: Propozim Plani financiar për vitin 2025 të IPK Ç.F “Ollga Miceska” Kërçovë .

UD Drejtori - Bën me dije se ka marrë detyrën me datë 08.10.2024. dhe shpjegoi planin.

Sibel Tufekci –Bën me dije se nuk ka vërejtje sa i takon planit, por ka dashur të shpreh personalisht qëndrimin e saj që të mbahet llogari për disa nga të punësuarit, të kontrollohen dhe të bëhet ndërrimi i turinit me edukatorë të caktuar. Ajo kërkoi që fëmijët të mos dhunohen psiqikisht dhe të merren masa për ta parandaluar këtë.

UD Drejtori – Informon se do të merren masa.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Plani financiar për vitin 2025 të IPK Ç.F “Ollga Miceska” Kërçovë dhe u miratua me 16 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 6 vota PËRMBAJTUR

15. PIKA E PESËMBËDHJETË: Propozim Plani financiar për vitin 2025 të IK U.P “Krste Mistirkov” Kërçovë.

Drejtori IPK UP „Krste Misirkov,, – sqaroi planin.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Plani financiar për vitin 2025 të IK U.P “Krste Mistirkov” Kërçovë dhe u miratua me 15 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 6 vota PËRMBAJTUR

16. PIKA E GJASHTËMBËDHJETË: Propozim Programi në lëminë e sportit dhe rekreimit për vitin 2025

Valdet Selimi – Bën me dije se shoqatat sportive në mbledhjen në komunë, të cilat kanë pasur një pjesëmarrje të ulët, nuk kanë propozuar ndonjë ide të re, por kanë kërkuar vetëm rritje të mjeteve. Më pas ai shpjegoi programin, duke theksuar se mjetet do të realizohen përmes një Thirrje Publike.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Programi në lëminë e sportit dhe rekreimit për vitin 2025 dhe u miratua me 22 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

17. PIKA E SHTATËMBËDHJETË: Propozim Programi për aktivitetet e Komunës së Kërçovës në lëmin e mbrojtjes dhe shpëtimit të qytetarëve dhe të mirave materiale nga fatkeqësit natyrore dhe fatkeqësitë të tjera si dhe revitalizimin pas eliminimit të krizës për vitin 2025.

Igor Pejovski - Informon se komuna në përputhje me Ligjin për menaxhim me kriza dhe Ligjin për mbrojtje dhe shpëtim, është dashur të miratojë një Program të tillë. Më pas shpjegoi programin.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Programi për aktivitetet e Komunës së Kërçovës në lëmin e mbrojtjes dhe shpëtimit të qytetarëve dhe të mirave materiale nga fatkeqësit natyrore dhe fatkeqësitë të tjera si dhe revitalizimin pas eliminimit të krizës për vitin 2025 dhe u miratua me 22 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

18. PIKA E TETËMBËDHJETË: Propozim Program dhe aktivitete në lëmin e menaxhimit me mjedisin jetësorë në Komunën e Kërçovës për vitin 2025.

Emilija Petkoska - Ajo shpjegoi programin dhe informoi se në vendbanimin “Deveana” ka filluar realizimi i projektit për seleksionimin e mbeturinave në kosha të posaçëm. Ajo gjithashtu theksoi se edhe në vitin 2025 do të shpërndahen kondicioner inverter.

Mihajlo Daniliski - Informon se çdo vit me program parashihej pastrimi i kanaleve në fshatrat Srbjan dhe Drugovë, por nuk është realizuar.

Emilija Petkoska – Informoi se dje është pastruar kanali në “Ivanidol” dhe theksoi se për seancën e ardhshme do të paraqesë raport për atë që është bërë.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Program dhe aktivitete në lëmin e menaxhimit me mjedisin jetësorë në Komunën e Kërçovës për vitin 2025 dhe u miratua me 22 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

19. PIKA E NËNTËMBËDHJETË: Propozim Plan dhe Program për zgjidhjen e problemit me kafshët e pa strehë në territorin e Komunës Kërçovës për vitin 2025.

Emilija Petkoska - Informon se programi është krijuar me mendimin e ekspertëve të veterinerëve, dhe më pas e sqaron.

Igor Stojanoski - Pyeti nëse programi parasheh ndërtimin e stacionit të qenve dhe si është planifikuar për periudhën e ardhshme.

Emilija Petkoska - Informon se ka pasur projekt për ndërtimin e stacionit, por problem nga ana e vendbanimeve ka qenë caktimi i lokacionit.

Olgica Poposka – Pyeti në lidhje me dëmshpërblimin e qytetarëve që janë kafshuar nga qentë. A është më i madh numri i atyre që kalojnë me marrveshje apo numri i atyre që kalojnë përmes avokatit? Ajo theksoi se në program është përfshirë edhe një donacion i huaj prej 20 milionë denarë për atë projekt.

Emilija Petkoska - Informon se paratë kanë qenë për atë qëllim, ndërsa sa i përket dëmshpërblimit, ka theksuar se ka pasur të interesuar për marrëveshje, por numri i atyre që kanë shkuar përmes avokatit ka qenë më i madh.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Plan dhe Program për zgjidhjen e problemit me kafshët e pa strehë në territorin e Komunës Kërçovës për vitin 2025 dhe u miratua me 21 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

20. PIKA E NJËZET: Propozim Plan dhe Program operativ për dezinfektim,dezinsekti dhe deratizim (si pjesë nga masat e përgjithsme për parandalimin dhe heqjen e smundjeve infektuese).

Emilija Petkoska – Informon se çdo vit, përfshirë edhe këtë, përgatitet një plan i tillë për mbrojtjen e popullatës.

Valentina Lazarevska - Informon se a është planifikuar monitorim për suksesin e programit. Ajo pyeti nëse ka pasur një vlerësim për këtë në çdo fazë të programit dhe çfarë duhej bërë nëse nuk kishte efekt.

Emilija Petkoska – Informon se duhet të ketë efekt, sepse trajtimi me spërkatje është bërë në terren nga epidemiologët. Komuna ka monitoruar nëse kjo është zbatuar.

Valentina Lazarevska – Pyet se çfarë do të ndodhte nëse trajtimi nuk do të kishte efekt.

Emilija Petkoska - Informon se nuk ka mundur të mos ketë efekt, sepse e bënte e gjithë Maqedonia, dhe kontrollin e kishte bërë Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe i Tregut.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Plan dhe Program operativ për dezinfektim,dezinsekti dhe deratizim (si pjesë nga masat e përgjithsme për parandalimin dhe heqjen e smundjeve infektuese) dhe u miratua me 20 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

21. PIKA E NJËZET E NJË : Propozim Program për Barazi gjinore në Komunën e Kërçovës për vitin 2025.

Kryetari i këshillit pyeti se a ka ndonjë pyetje dhe meqë askush nuk e morri fjalën, e vendosi për miratim Propozim Program për Barazi gjinore në Komunën e Kërçovës për vitin 2025 dhe u miratua me 21 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

22. PIKA E NJËZET E DY: Propozim Program Per aktivitet e Komunës së Kërçovës në lëminë e Arsimit për Vitin 2025.

Burim Kadriu - Informon se programi është krijuar në bazë të ideve dhe kërkesave të të rinjve dhe drejtorëve në takimet e mbajtura në komunë për përfshirjen e tyre në buxhet.

Valentina Lazarevska – Informon se ishte hera e parë që miratohej një program i tillë dhe ai përmbante aspekte të rëndësishme. Ajo kërkoi që pika 1 të trajtohet veçmas për shkollat fillore dhe të mesme dhe të ketë ndryshim në mbajtjen e mësimit dhe të vendoset shpërblimi për mentorët. Pyeti se si do të përcaktohet kriteri për nxënësin më të mirë në arsimin fillor dhe të mesëm.

Burim Kadriu – Bën me dije se me atë program është përcaktuar korniza dhe shkollat së bashku me Sektorin e Arsimit do të përcaktojnë kriteret për mënyrën e përcaktimit të nxënësit më të mirë.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Program Per aktivitet e Komunës së Kërçovës në lëminë e Arsimit për Vitin 2025 dhe është miratuar me 20 vota PËR, KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

23. PIKA E NJËZET E TRE: Propozim Progam për aktivitetet nga lëmia e Mbrojtjes Shëndetësore në Komunën e Kërçovës për vitin 2025.

Burim Kadriu - Informon se ky ishte një program ku për herë të parë janë ndërmarrë aktivitete për mbrojtjen e shëndetësië, për shëndetin e grave për kancerin e gjirit, për diabetin, për autizmin, për HIV-in, pajisje për institucionet shëndetësore etj.

Olgica Poposka - Informon se është e nderuar që ky program është futur në buxhet pas tre vitesh dhe se është shumë i rëndësishëm për shëndetin e popullatës. Ajo uroi realizimin e saj dhe, nëse është e mundur, që ajo të përfshihej në të.

Valentina Lazarevska - Informon se mbrojtja e shëndetit mendor ka qenë akute kohëve të fundit dhe sugjeron që edhe kjo të parashihet pasi që ka hyrë në arsimin fillor.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Program për aktivitetet nga lëmia e Mbrojtjes Shëndetësore në Komunën e Kërçovës për vitin 2025 dhe është miratuar me 20 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Kryetari i këshillit dha një pushim prej 10 minutash. Pas pushimit seanca vazhdoi.

Meqenëse pika 24 u tërhoq nga rendi i ditës për seancën e radhës, kalohet në:

25. PIKA E NJËZET E PESTË: Propozim Program për financimin e aktiviteteve nga lëmia e kulturës nga interesi i Komunës së Kërçovës dhe përkrahje shoqatave të qytetarëve për vitin 2025.

Kryetari i këshillit pyeti nëse e do dikush fjalën, por meqë askush nuk foli, e vendosi për miratim Propozim Program për financimin e aktiviteteve nga lëmia e kulturës nga interesi i Komunës së Kërçovës dhe përkrahje shoqatave të qytetarëve për vitin 2025 dhe u miratua me 17 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

26. PIKA E NJËZET E GJASHTË: Propozim Program për aktivitetet e Komunës së Kërçovës në lëminë e Mbrojtjes sociale dhe mbrojtje të fëmijëve gjatë vitit 2025.

Burim Kadriu ka shpjeguar programin.

Olgica Poposka - Informon se si profesioniste e shëndetësisë çdo ditë ka qenë dëshmitare e viktimave të dhunës në familje, por nuk kanë pasur ku të shkojnë për përkujdesje. Ajo propozoi që të parashikohet ndërtimi i qendrave për kujdesin e tyre. Nëse është e mundur Komuna në bashkëpunim me Qendrën për Punë dhe Çështje Sociale, të lirojë hapsira për kujdesin e tyre.

Burim Kadriu - Informon se janë të gatshëm për bashkëpunim dhe kanë bashkëpunuar me ta për kuzhinën popullore.

Olgica Poposka - Ajo propozoi ndërtimin e një objekti për të moshuarit me Partneritet Publik Privat, sepse edhe kjo ishte problem.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Program për aktivitetet e Komunës së Kërçovës në lëminë e Mbrojtjes sociale dhe mbrojtje të fëmijëve gjatë vitit 2025 dhe është miratuar me 20 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

27. PIKA E NJËZET E SHTATË: Propozim Program për aktivitetet e Komunës së Kërçovës për mbrojtje nga zjarret gjatë vitit 2025.

Burim Kadriu - Informon se ky program po parashikohet për herë të parë dhe ka përfshirë mjete për paga, trajnime uniforme, furnizimi me automjete të reja për zjarrfikës, për shoqata vullnetare etj.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Program për aktivitetet e Komunës së Kërçovës për mbrojtje nga zjarret gjatë vitit 2025 dhe është miratuar me 20 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

28. PIKA E NJËZET E TETË : Propozim Program për menaxhim me mbeturinat në teritorin e Komunës së Kërçovës për vitin 2025

Zëvendësdrejtori i NP “Komunalec” – Informon se ky program parashikon mënyrën dhe dinamikën e grumbullimit të mbeturinave, qëllimet dhe organizimin për to.

Argjent Asani - Pyeti nëse programi parashikon grumbullimin e mbeturinave dhe në Zajaz dhe ish komunat.

Zëvendësdrejtori i NP “Komunalec” Theksoi se pengesë për grumbullimin e mbeturinave ka qenë mungesa e një deponie. Paketimi do të reduktojë një pjesë të mbeturinave, por nevojitet një deponi.

Igor Stojanoski - Informon se në afërsi të komunës, afër varrezave të vjetra, ka qenë një mini-deponi me kontejnerë dhe kosha të vjetra të shpërndara përreth, dhe për këtë fajtor me pakujdesinë e tyre kanë qenë edhe qytetarët. Ai sugjeroi vendosjen e shportave të reja atje.

Zëvendësdrejtori i NP “Komunalec” –Informon se do ta marrin parasyshë që ta realizojnë këtë.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Program për menaxhim me mbeturinat në teritorin e Komunës së Kërçovës për vitin 2025 dhe është miratuar me 14 vota PËR, KUNDËR (asnjë). 5 vota PËRMBAJTUR.

Këshilltari Mihajllo Daniloski është liruar nga votimi për shkak se është i punësuar në ndërmarrje.

29. PIKA E NJËZET E NËNTË : Propozim Program për punë dhe zhvillim të Ndërmarrjes publike për veprimtari komunale “Komunalec” Kërçovë për vitin 2025.

Zëvendësdrejtori i NP “Komunalec” ka shpjeguar programin, duke bërë të ditur se nuk ka pasur ndryshime nga viti i kaluar.

Igor Stojanoski - Pyet se pse në planin për furnizim publik për vitin 2025 thuhet një veturë “pajak” 2 milionë denarë dhe diçka dhe shërbime për “pajak” prej 3 milionë denarë, ai ka kërkuar sqarim për këtë.

Zëvendësdrejtori i NP “Komunalec” – bën të ditur se 2 milion denarë për automjetin „Pajak,, është parashikuar për vitin 2024 dhe këtu ishte paraparë ajo që nuk u realizua, ndërsa 3 milionë ishte gabim, sepse po të ishte marrë nuk do të kishte nevojë, nuk do të kishte nevojë për ekzekutim paralel, po të kishte automjet.

Valentina Lazarevska - Pyeti nëse drejtori e dinte se në f.Osoj nuk kishte ujë dhe cili ishte problemi?

Zëvendësdrejtori i NP “Komunalec” –Theksoi se është në dijeni për këtë. Gjatë verës konsumohej më shumë ujë dhe furnizimi bëhej me pompa elektrike, kështu që pjesa më e lartë nuk kishte ujë. Kishte një projekt me f.Rashtani që të ndërtonin një rezervuar dhe kjo do të ishte zgjidhur. Ai bëri të ditur se nuk ka qenë kështu gjatë gjithë kohës, por vetëm kur elektropompat kanë pasur një defekt dhe kur janë riparuar nuk ka qenë kështu.

Valentina Lazarevska – Informon se nuk ishte e vërtetë që vetëm disa ditë nuk kishin ujë, por vazhdimisht ishte kështu.

Igor Stojanoski - Informon se në tabelën e të hyrave të realizuara nga shërbimet funerale ishin paraparë 3 milionë e 360 mijë denarë. Situata atje nuk kishte ndryshuar prej vitesh. Ai kërkoi që ato 360 mijë denarë të ndahen për renovim atje.

Zëvendësdrejtori i NP “Komunalec” Theksoi se prej 10 vitesh nuk ka çmime të reja për varrezat. Tarifa komunale atje ishte 60 denarë. Ai shpreson se situata do të përmirësohet atje.

Ivan Bozhinoski – Pyeti nëse mund të shihet ndonjë gjë konkrete, p.sh. në dy javë. Ai sugjeroi që dy punëtorë të shkonin atje dhe të fshinin. Për këtë reagues të gjithë qytetarët, jo vetëm Igori.

Zëvendësudrejtori i NP “Komunalec” bëri të ditur se aty nga nesër do të ketë kontejnerë të rinj, ndërsa pjesa tjetër varet nga kushtet atmosferike për të pasur ekipe në terren.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Program për punë dhe zhvillim të Ndërmarrjes publike për veprimtari komunale “Komunalec” Kërçovë për vitin 2025 dhe është miratuar me 13 vota PËR. 1 votë KUNDËR. 5 vota PËRMBAJTUR.

Këshilltari Mihajllo Daniloski është liruar nga votimi për shkak se është i punësuar në ndërmarrje.

30. PIKA E TRIDHJETË: Propozim Program për mirmbajtje të pastërtisë publike për vitin 2025 në Komunën e Kërçovës.

Kryetari i këshillit pyeti nëse e do dikush fjalën, por meqë askush nuk foli, ai e vendosi për miratim Propozim Program për mirmbajtje të pastërtisë publike për vitin 2025 në Komunën e Kërçovës dhe u miratua me 13 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 6 vota PËRMBAJTUR.

Këshilltari Mihajllo Daniloski është liruar nga votimi për shkak se është i punësuar në ndërmarrje.

31. PIKA E TRIDHJETË E NJË: Propozim Vendim për dhënien e banesës sociale për shfrytëzim nën qira.

Kryetarja e Komisionit për veprimtari sociale dhe bashkëpunim me organizatat joqeveritare, Daniela Poposka, e lexoi raportin nga mbledhja e komisionit.

Kryetari i këshillit pyeti nëse dikush dëshiron ta marrë fjalën, por duke qenë se askush nuk u paraqiti, ai e vendosi për miratim Propozim Vendim për dhënien e banesës sociale për shfrytëzim nën qira, dhe i njeiti u miratua me 19 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR(asnjë).

32. PIKA E TRIDHJETË E DY: Propozim Vendim për kofinancim të Projektit

Sekretari i Komunës – Informon se bëhet fjalë për kofinancim të projektit për rikonstruimin e objektit administrativ në komunën e Kërçovës në rrugën “Marshal Tito”, i ashtuquajhuri Inspektorat. Projekti u financua nga Byroja për Zhvillim Rajonal

përmes Rajonit Planifikues Jugperëndimor. Gjatë ndërtimit, u shfaq një mungesë mjetesh që Byroja refuzoi t'i paguante. Nëse ky vendim do të votohet, komuna do të kontribuojë me 394.659,00 denarë.

Valentina Lazarevska - Pyeti se a ishte rajoni Juglindor apo Jugperëndimor, sepse kështu ishte shkruar në Vendim.

Sekretari i Bashkisë – bën me dije se bëhet fjalë për rajon Jugperëndimor.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim për kofinancim të Projektit dhe është miratuar me 13 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 6 vota PËRMBAJTUR.

33.PIKA E TRIDHJETË E NJË: Të ndryshme

Valentina Lazarevska - Pyeti nëse është dërguar kërkesa nga B.L Klenoec, sepse nuk kanë marrë përgjigje.

Sekretari i Komunës – bën të ditur se është takuar disa herë me ta. Ajo nuk kishte asnjë përgjigje për momentin, kërkesa ishte marrë në shqyrtim dhe do ta njoftojë në kohën e duhur.

Pasi që askush nuk e morri fjalën, dhe me këtë rendi i ditës u shterë për këtë seancë, Kryetari i këshillit e mbylli seancën në ora 14 e 30 minuata.

Procesverbalist

-Lençe Srbinoska

Këshilli i Komunës së Kërçovës
Kryetar
Skender Xhabiri d.v.

Përkthyes:Tefik Asani

